



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

BASHKIA DURRËS SHPALL:

THIRRJE PUBLIKE PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE PËR DORËZIMIN E PROPOZIMEVE FINANCIARE NË REALIZIM TË SHËRBIMIT “SHËRBIM PSIKOLOGJIK, LIGJOR DHE LINJA TELEFONIKE, PËR VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE”

Bashkia Durrës hap thirrjen për propozime financiare në realizim të shërbimit “Shërbim psikologjik, ligjor dhe linja telefonike, për viktimat e dhunës në familje”, të financuar nga buxheti lokal, ka për qëllim zvogëlimin e të gjitha formave të praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, ofrimit të shërbimeve mbështetëse të specializuara për viktimat.

Bashkia Durrës fton të gjitha Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të) që të paraqesin propozime që janë në përputhje me shërbimin dhe qëllimin e tij në mbështetje për shërbime të specializuara për jo më pak se 60 raste të viktimave të DHF/DHBGJ mbi 18 vjeç.

Të gjitha organizatat e shoqërisë civile të interesuara mund të gjejnë informata të hollësishme rreth kushteve për aplikim si dhe për kriteret për financimin e projekteve në Udhëzimin për Aplikant, që është pjesë përbërëse e dokumentacionit të thirrjes publike.

Shuma e fondit për këtë shërbim do të jetë jo më shumë se **2,700,000 lekë në vit (TVSH e përfshirë)**. Kontrata do të ketë një kohëzgjatje për 36 muaj, të rinovueshme cdo vit.

Dokumentacioni i aplikimit për thirrjen publike të Bashkisë Durrës do të jetë i disponueshëm nga data **25.10.2024**. Një version elektronik i paketës së aplikimit mund të gjendet edhe në web-faqen zyrtare të Bashkisë (<http://www.durres.gov.al>).

Thirrja për projekt-propozime hapet në datën **25.10.2024** dhe mbyllet me datë **11.11.2024**, ora **16.00**.